MammaPrint® + BluePrint® teste për kancerin e gjirit në stad të hershëm



Dija ka rëndësi

Përballja me kancerin është mjaft e vështirë.
Vendimet për trajtimin duhet të jenë më të qarta.


PROLAB
Qendra Diagnostike Laboratorike

GenoLab
PRECIZNA MEDICINA


Së bashku, MammaPrint + BluePrint analizojnë gjithsej 150 gjene në tumorin tuaj të gjirit

AGENDIA® MAMMAPRINT

3 nga 4 gra me kancer gjiri në stad të hershëm kanë rrezik të ulët të rikthimit të sëmundjes dhe mund ta shmangin në mënyrë të sigurt kimioterapinë.[1]




MammaPrint analizon 70 gjene në tumor për të vlerësuar mundësinë e rikthimit të kancerit. Sipas rezultatit, tumori klasifikohet në një nga katër grupet: rrezik shumë i ulët, rrezik i ulët, rrezik i lartë 1 ose rrezik i lartë 2. Së bashku me të dhëna të tjera, si mosha, madhësia e tumorit dhe prekja e nyjeve limfatike, këto rezultate ju ndihmojnë juve dhe mjekun tuaj të zgjidhni trajtimin nga i cili mund të përfitoni më shumë.




AGENDIA® BLUEPRINT

Në rreth 1 nga 4 raste, testi jep të dhëna klinike shtesë krahas gjetjeve patologjike.[2]



BluePrint analizon 80 gjene të tjera në tumor për të përcaktuar nëntipin e tij molekular. Tre nëntipet kryesore janë luminal, HER2 dhe bazal. Secili sillet dhe i përgjigjet trajtimit ndryshe. Njohja e nëntipit e ndihmon ekipin të hartojë një plan të përshtatur për ju: kur të kryhet trajtimi (para apo pas operacionit), cili trajtim të përdoret dhe cilat mundësi mund të jenë më të efektshme.



1 Cardoso F, van't Veer LJ, Bogaerts J et al. 70-Gene Signature as an Aid to Treatment Decisions in Early-Stage Breast Cancer. N Engl J Med 2016;375:717-29.
2 Whitworth, P., et al. Ann Surg Oncol (2022) 29:4141–4152

Besojmë se të gjithë të prekurit nga kanceri kanë të drejtë për **testim gjenomik të cilësisë më të lartë**

Një diagnozë e re e kancerit të gjirit mund të jetë tronditëse: sjell emocione të forta, terma të panjohur dhe informacione të ndërlikuara mjekësore.

Testimi gjenetik dhe testimi gjenomik janë dy lloje të ndryshme testesh që shpesh ngatërrohen. Në diagnostikimin e kancerit të gjirit, këto terma kanë kuptime të ndryshme.

Testimi gjenetik shqyrton gjenet e trashëguara për të kuptuar nëse keni lindur me rrezik më të lartë për kancer. Ky informacion mund t'ju ndihmojë juve dhe familjen në vendimet për parandalimin, zbulimin e hershëm dhe trajtimin.



Mendojeni testimin gjenetik si shqyrtimin e ***"historisë familjare të shkruar në gjenet tuaja".***

Testimi gjenomik shqyrton gjenet brenda tumorit për të kuptuar sjelljen e tij. Ndihmon në vlerësimin e mundësisë së rritjes, përhapjes ose rikthimit të kancerit dhe të efektshmërisë së trajtimeve të caktuara, si kimioterapia.



Mendojeni testimin gjenomik si analizën e ***"sjelljes ose personalitetit" të tumorit.***

Një rrugë më e qartë drejt trajtimit

MammaPrint + **BluePrint** janë dy teste gjenomike që mund të sjellin qartësi në një periudhë të vështirë. Duke analizuar sjelljen e tumorit tuaj, japin informacione të rëndësishme për vendime trajtimi të përshtatura për ju, në mënyrë që ju dhe ekipi juaj të planifikoni me më shumë siguri hapat e ardhshëm.

Si kryhen testet MammaPrint + BluePrint



Hapi 1:

Zakonisht në laborator dërgohet indi nga biopsia fillestare, ndaj nuk nevojitet ndërhyrje shtesë. Nëse operacioni është kryer tashmë, mund të përdoret edhe indi nga mostra kirurgjikale.



Hapi 2:

Rezultatet i dërgohen mjekut tuaj brenda 7-10 ditësh.*



Hapi 3:

Ju dhe mjeku i shqyrtoni rezultatet së bashku për të zgjedhur trajtimin më të përshtatshëm për ju.

Rezultatet e testeve **MammaPrint + BluePrint** plotësojnë të dhënat e zakonshme që ekipi juaj tashmë po shqyrton:

- Madhësia e tumorit
- Grada e tumorit
- Statusi i receptorëve të estrogjenit
- Statusi i receptorëve të progesteronit
- Statusi i receptorit HER2
- Mosha në diagnozë
- Prekja e nyjeve limfatike
- Planifikimi familjar
- Mutacionet gjenetike
- Statusi i menopauzës

Të dhënat e zakonshme + **MammaPrint + BluePrint** = **Një pamje më e plotë e tumorit tuaj**

*7-10 ditë nga pranimi i mostrës së tumorit në laboratorin Agendia.

MammaPrint + **BluePrint** ndihmojnë në vendime të rëndësishme gjatë trajtimit tuaj të kancerit të gjirit.

Para operacionit

- A duhet fillimisht operacioni apo trajtimi me barna?
- Si mund t'i përgjigjet tumori im kimioterapisë para operacionit?

Pas operacionit

- A do të përfitoj nga kimioterapia?

Jeta pas trajtimit

- A do të përfitoj nga terapia hormonale?
- Për sa kohë do të më duhet terapia hormonale?
- Çfarë mundësish të tjera kam nëse kam shumë efekte anësore nga terapia hormonale standarde?

Rezultatet paraqiten në një përmbledhje të qartë

Shembull ilustrues i raportit

Përmbledhje e rezultateve MammaPrint® dhe BluePrint®

Emri dhe mbiemri: Mbiemri, Emri

Mosha: 73 | Datëlindja: 01.06.1950. | ID e mostrës: SID-124856789XX | MRN: MRN-123456789XX

AGENDIA
MAMMAPRINT + BLUEPRINT


TË DHËNAT KLINIKE

Statusi i receptorëve: ER+ / PR+ / HER2−
Grada e tumorit: 1
Mostra: FFPE, biopsi me gjilpërë të trashë
Statusi i nyjeve limfatike: negativ
Madhësia e tumorit: 2.8 cm
Mosha: >50 vjeç

Të dhënat klinike u përcaktuan nga informacioni i dërguar gjatë porositjes së testit nga institucioni:
Test Pathology Lab, 123 Main St., Irvine, CA 92618

REZULTATET E TESTIMIT GJENOMIK

MammaPrint Grupi i rrezikut	MammaPrint Indeksi	Nëntipi molekular BluePrint
Rrezik i ulët	**+0.300**	**Luminal A**



RËNDËSIA KLINIKE

Planifikimi i kimioterapisë neoadjuvante

Probabiliteti i pCR-së me kimioterapi neoadjuvante

2%

NBRST[A]

Planifikimi i kimioterapisë adjuvante

Përfitimi absolut nga kimioterapia

<1.0%

MINDACT[D]

Intervali 5-vjeçar pa metastaza të largëta vetëm me terapi endokrine

Nyjet limfatike negative	Nyjet limfatike pozitive
98%	**96%**

MINDACT[D]

Planifikimi i terapisë endokrine adjuvante

Përfitimi nga terapia endokrine standarde

Po

STO-3[C]

Përfitimi absolut nga terapia endokrine e zgjatur (DFS)

9.5%

Ulja e rrezikut të rikthimit të vonshëm (vitet 5-15)

NSABP B-42[E]

DFS: mbijetesa pa sëmundje | MPI: indeksi MammaPrint | pCR: përgjigje e plotë patologjike

Shënim: Kjo përmbledhje shërben për informacion të përgjithshëm dhe nuk është pjesë e raportit zyrtar diagnostik. Për komente, të dhëna për testin dhe referenca, konsultoni raportet individuale MammaPrint dhe BluePrint. Përfitimi i pritshëm nga kimioterapia bazohet në zbatimin e trajtimit sipas udhëzimeve dhe afateve kohore standarde.

Agendia, Inc.
22 Morgan, Irvine, CA 92618 | Phone: 888.321.2732 | Fax: 844.711.9132 | customercare@agendia.com | www.agendia.com
Radarweg 60, 1043 NT Amsterdam, Netherlands | Phone: +31.(0)20.462.1510 | customerservice@agendia.com | www.agendia.com



A janë MammaPrint + BluePrint të përshtatshme për ju?

Testimi mund të jetë i përshtatshëm nëse:[1]

Kanceri është në stad të hershëm (I, II ose III i operueshëm).

Nyjet limfatike nuk janë të prekura ose janë pozitive 1-3 nyje.

Madhësia e tumorit është më e vogël se 5 cm.

INFORMACION PËR SIGURIMIN NË SHBA

MammaPrint + BluePrint janë gjerësisht të disponueshme në SHBA dhe shumica e pacienteve paguajnë nga 0 USD deri në një bashkëpagesë minimale.[1]

1. Përdorimi i parashikuar sipas FDA-së (SHBA): testi kryhet te pacientet me kancer gjiri në stadin I ose II, me tumor ≤5.0 cm dhe pa prekje të nyjeve limfatike. Rezultati MammaPrint® FFPE përdoret nga mjeku vetëm si tregues prognostik, krahas faktorëve të tjerë klinikopatologjikë. Kriteret e shumicës së sigurimeve amerikane përfshijnë kancerin e hershëm të gjirit, tumorin ≤5.0 cm dhe deri në tri nyje limfatike pozitive, pavarësisht statusit të receptorëve, siç është vërtetuar në studimin MINDACT me 6,693 paciente.

Jemi këtu për pyetjet tuaja.

Për informacione rreth testeve MammaPrint dhe BluePrint, përgatitjes së mostrës dhe porositjes, kontaktoni GenoLab ose Prolab në Prishtinë.

GenoLab d.o.o.

Mis Irbina 24
71000 Sarajevo, BiH
+387 67 1300 035
office@genolab.ba
www.genolab.ba

Prolab, Prishtinë

Rr. Mark Dizdari
10000 Prishtinë, Kosovë
+383 49 789 410
info@prolab-ks.com
www.prolab-ks.com
Hën-Sht: 08:00-21:00
Të dielën: pushim

SKANONI PËR INFORMACIONE
DHE POROSITJE

PROLAB
Qendra Diagnostike Laboratorike

GenoLab
PRECIZNA MEDICINA

Burimi: Agendia, MKT354-V2. Përshtatja në shqip: GenoLab / Prolab, Prishtinë.